

**3P Life Logistic sh.p.k.**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## PËRMBAJTJA

	PAGE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8 – 28

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR****Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë 3P Life Logistic sh.p.k.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të 3P Life Logistic sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të përshkruara në paragrafin 1 dhe 2, Baza për Opinion me rezervë të këtij raporti, pasqyrat financiare të bashkëlidhura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 të hartuara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Sikundërse është paraqitur në shënimin 15 të pasqyrave financiare, më 31 dhjetor 2018 të ardhurat nga shërbimet kanë vlerën 730,075,000 Lek (më 31 dhjetor 2017: 730,773,785 Lek). Bazuar në kontratën fillestare të koncesionit Shoqëria do të njohë të ardhura nga kontrolli i përgjithshëm "check-up", minimalisht **Baza për opinionin me rezervë**

1. në sasinë 475.000 dhe vlerën 730,075,000 Lek, të pagueshme tek klientët drejtperdrejte nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor "FSDKSH". Në vijim të ndryshimit të Aneksit 12 të kontratës së koncesionit më 11 nëntor 2016, në rastin se numri i kontrolleve të përgjithshme "check up" do të tejkalonte nivelin e përcaktuar sipas kontratës fillestare, sasia dhe vlera do të kompensohen me "check-up" të përcaktuar në vitet e mëparshme (deficit të sasisë minimale). Pagesat e pranuar për vitet pasuese (2017 e tutje) nga FSDKSH për kontrolle të përcaktuara (kur sasia minimale nuk u arrit, por është paguar nga FSDKSH) paraqesin një të ardhur të shtyrë e cila do të lëshohet në vitet pasuese, pasi të tejkalohet sasia minimale. Ne jemi vënë në dijeni të këtij vendimi gjatë auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Shoqëria nuk është në përputhje me kërkesat e IFRS-ve, të cilat do të kërkonin riklasifikimin e të ardhurave në të ardhura të shtyra në vlerën 70,869,533 Lek më 31 dhjetor 2018 (243,459,263 Lek më 31 dhjetor 2017). Nëse Shoqëria do të kishte zbatuar metodën e duhur të kontabilizimit, të ardhura të shtyra do të ishin rritur me 314,328,796 Lek më 31 dhjetor 2018 (31 dhjetor 2017: 243,459,263 Lek), balance e tatimit të shtyrë do të ishte rritur me 49,001,393 Lek më 31 dhjetor 2018 (31 Dhjetor 2017: 37,819,648 Lek), fitimi neto do të ishte ulur me 59,687,788 Lek për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 (31 Dhjetor 2017: 205,639,615 Lek) dhe kapitali aksionar do të ishte ulur me 265,327,403 Lek më 31 Dhjetor 2018 (31 Dhjetor 2017: 205,639,615 Lek).
2. Ne u emëruam si auditues të Shoqërisë më 7 maj 2018 dhe si pasojë nuk ishim të pranishëm në numërimin e inventarit fizik për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Ne nuk arritëm të bindemi duke përdorur mjete alternative në lidhje me vlerësimin e sasisë së inventarit të imët të mbajtur në atë datë, të cilat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar respektivisht me vlerë 24,540,293 Lek. Duke qënë se balanca hapëse e inventarit është përcaktuese për performancën financiare dhe flukset monetare per vitin 2018, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse mund të kenë qënë të nevojshme rregullime në lidhje me fitimin për vitin e raportuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe flukset monetare neto nga aktivitetet operative të raportuara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare

## **Baza për opinionin me rezervë (vazhdim)**

- Opinionin ynë i auditimit për pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 u modifikua për shkak të çështjes së mësipërme. Mendimi ynë për pasqyrat financiare të periudhës aktuale është modifikuar gjithashtu për shkak të efektit të mundshëm të kësaj çështje në krahasueshmërinë e shifrave të periudhës aktuale dhe shifrave përkatëse. Ne nuk arritëm të bindemi duke përdorur mjete alternative në lidhje me vlerësimin e inventarit të imët të mbajtur më 31 dhjetor 2018, të cilat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar respektivisht me vlerë 18,877,773 Lek. Për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse mund të kenë qënë të nevojshme rregullime në lidhje me inventarin më 31 dhjetor 2018 dhe fitimin e vitit të raportuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe flukset monetare neto nga aktivitetet operative të raportuara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare.

## **Theksim i çështjes**

Theksojme çështjen në shënimin 2.3 të pasqyrave financiare në të cilën përshkruhet vlerësimi i Menaxhimit për ndikimin aktual ose të mundshëm të efekteve të koronavirusit COVID-19 në Shoqëri. Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania Sh.p.k.*

Deloitte Audit Albania Sh.p.k.  
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010,  
Tiranë, Shqipëri  
Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L41709002H



Olindo Shehu  
Auditues Ligjor

*Olindo Shehu*  
Tiranë, Shqipëri  
8 prill 2020

**3P Life Logistic sh.p.k.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018**

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Shënime	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	Më 1 Janar 2017 (riparaqitur)
<b>Aktivitet</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	4	171,196,803	205,383,594
Aktive afatgjata jomateriale – Kontrata e Konçesionit	5	213,549,868	283,578,802
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>384,746,671</b>	<b>488,962,396</b>
<b>Aktive afatshkurta</b>			
Inventarët	6	18,877,773	28,150,056
Llogari të arkëtueshme dhe aktive të tjera	7	147,512,068	300,306,119
Parapagim Tatim Fitimi		3,393,492	23,721
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	8	43,804,353	108,149,230
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>213,587,686</b>	<b>436,629,126</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>598,334,357</b>	<b>925,591,522</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	9	146,875,553	75,970,005
Kapital i nënshkruar por i papaguar		(4,167,415)	-
Fitimi i pashpërndarë		52,234,028	-
Fitimi i vitit		51,938,620	66,738,133
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>246,880,786</b>	<b>142,708,138</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Vlera e riinvestimit	10	104,169,108	85,550,835
Detyrime të tjera afatgjata	11	145,908,411	281,495,110
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>250,077,519</b>	<b>367,045,944</b>
<b>Detyrime afatshkurta</b>			
Llogaritë e pagueshme	12	88,062,927	378,557,339
Grant aparatura abbott	13	-	27,219,958
Detyrime të tjera	14	13,313,125	10,060,143
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>101,376,052</b>	<b>415,837,440</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR DHE DETYRIMEVE</b>		<b>598,334,357</b>	<b>925,591,522</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 8 prill 2020 dhe firmosur nga:

Z. Altin Fani

Drejtor Menaxhimi



Zj. Manjola Seferi

Menaxhere Finance & Administrative



**3P Life Logistic sh.p.k.****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Shumat janë të shprehura në Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhura nga shërbimet	<b>15</b>	730,075,000	730,773,785
Të ardhura të tjera	<b>16</b>	11,107,347	18,964,982
		741,182,347	749,738,767
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>730,075,000</b>	<b>730,773,785</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për kontratën e konçesionit	<b>17</b>	(342,329,651)	(270,573,005)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	<b>4,5</b>	(70,062,087)	(70,597,697)
Shpenzime personeli	<b>18</b>	(120,580,403)	(136,018,946)
Shpenzime operative dhe të tjera	<b>19</b>	(132,857,712)	(198,500,779)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(665,829,854)</b>	<b>(675,690,427)</b>
<b>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>75,352,494</b>	<b>74,048,340</b>
<b>Të ardhurat / shpenzimet financiare</b>			
Të ardhurat / shpenzimet financiare, neto		(9,767,020)	(8,851,253)
Fitim nga kursi i këmbimit	<b>20</b>	45,730	-
		(9,721,290)	(8,851,253)
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>		<b>(9,767,020)</b>	<b>(8,851,253)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>65,631,204</b>	<b>65,197,087</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	<b>21</b>	(13,692,584)	(12,963,059)
<b>Fitimi neto</b>		<b>51,938,620</b>	<b>52,234,028</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>51,938,620</b>	<b>52,234,028</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**3P Life Logistic sh.p.k.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2018***(Shumat janë të shprehura në Lek)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Kapital i nënshkruar por i papaguar</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>75,970,005</b>	<b>-</b>	<b>66,738,133</b>	<b>142,708,138</b>
Rritja e kapitalit	70,905,548		(66,738,133)	<b>4,167,415</b>
Kapital i nënshkruar por i papaguar	-	(4,167,415)	-	<b>(4,167,415)</b>
Fitimi i vitit	-		52,234,028	<b>52,234,028</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>146,875,553</b>	<b>(4,167,415)</b>	<b>52,234,028</b>	<b>194,942,165</b>
Rritja e kapitalit	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	51,938,619	<b>51,938,619</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>146,875,533</b>	<b>(4,167,415)</b>	<b>104,172,646</b>	<b>246,880,784</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



**3P Life Logistic sh.p.k.****Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Shumat janë të shprehura në Lek)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga aktivitetet operative:</b>		
Fitimi para tatimit	65,631,204	65,197,087
<b>Rregullime për:</b>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	69,733,622	69,762,959
Humbje nga shitja e aktiveve	328,465	834,737
<b>Fitimi nga aktiviteti para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>135,693,291</b>	<b>135,794,784</b>
Zvogëlim (rritje) në inventar	18,622,561	(9,350,278)
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	11,603,912	141,190,139
Zvogëlim në llogaritë e pagueshme	(112,282,688)	(313,798,423)
Rritje në detyrime të tjera	3,050,324	202,658
Tatimi fitimi i paguar	(16,602,317)	(13,423,101)
Zvogëlim granti	(9,587,803)	(17,632,155)
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga aktivitetet operative</b>	<b>(105,196,011)</b>	<b>(212,811,160)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata (net)	(7,463,716)	(35,624,990)
Rritje (zvogëlim) në riinvestim	9,767,021	8,851,254
Shitja e aktiveve	834,738	5,809,913
<b>Paraja neto e gjeneruar (përdorur) në aktivitetet investuese</b>	<b>3,138,042</b>	<b>(13,694,699)</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>	<b>33,635,322</b>	<b>(97,980,199)</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	10,169,031	108,149,230
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit</b>	<b>43,804,353</b>	<b>10,169,031</b>

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **1. HYRJE**

3P Life Logistic sh.p.k. (Shoqëria) është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e regjistruar më 9 dhjetor 2014 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Autostradën Tiranë – Durrës, km 9.

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga 80% të totalit të kapitalit të nënshkruar të aksioneve nga Marketing & Shpërndarjes Sh.p.k. dhe 20% nga Trimed Sh.p.k.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Shoqërisë përfshin paketën e shërbimit të kontrollit mjekësor për moshat 40-65 vjeç, për një periudhë prej 10 vjetësh, siç parashikohet në marrëveshjen e konçesionit nënshkruar ndërmjet 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë, më 7 janar 2015.

Me vendim nr. 185 të Këshillit të Ministrave grupmohat që përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë janë 35-70 vjeç.

Më 31 dhjetor 2018, Shoqërisa ka të punësuar 151 punonjës (më 31 dhjetor 2017: 155 punonjës).

### ***Marrëveshja e konçesionit***

#### ***Përshkrim i marrëveshjes***

Bazuar në marrëveshjen e konçesionit të firmosur mes 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë më 31 mars 2015, Ministria e Shëndetësisë autorizon Shoqërinë të planifikojë, financojë dhe zbatojë paketën e shërbimit të kontrollit mjekësor për moshat 35-75 vjeç sic detajohet më poshtë:

#### **a) Paketa bazë e kontrollit mjekësor**

Shoqëria do të sigurojë pajisjet, mjetet dhe materialet mjekësore ose jo mjekësore për të siguruar shërbime logjistike dhe për të zbatuar paketën e Kontrollit Bazë Mjekësor.

Shoqëria merr përsipër të furnizojë Qendrat Shëndetësore me mjetet dhe materialet e nevojshme për kontrollin bazë, transportimin e kampioneve nga Qendrat Shëndetësore në Laboratorët e Konçesionarit, ekzaminimin e tyre dhe hedhjen e rezultateve në Sistem.

#### **b) Serveri i aplikimeve:**

- Dixhitalizimi i të dhënave mjekësore;
- Hyrja dhe ruajtja e të dhënave në faqen qendrore të personalizuar dhe ndertimin e mbështetjes (backup);

#### **c) Baza e të dhënave:**

- Ruajtja e të dhënave dhe përdorimi i tyre;
- Trajtimi dhe përpunimi i të dhënave;

#### **d) Software i ndërtimit të indikatorëve të monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të kontrollit mjekësor bazë:**

- Oracle business intelligence

#### **e) Sistemi i auditimit:**

- Mbrojtja e të dhënave konfidenciale
- Automatizimi i të dhënave të auditit
- Menaxhimi i centralizuar i regjistrit të të dhënave.

#### ***Periudha e konçesionit:***

Konçesioni është dhënë për një periudhë 10 vjecare, duke filluar më 31 mars 2015.

Në fund të kontratës Shoqëria do të kthejë Ministrisë së Shëndetësisë të gjitha pajisjet, materialet mjekësore dhe jo-mjekësore dhe pajisjet e qendrave shëndetësore të kontratës së konçesionit.

Të gjitha strukturat e tjera, që nuk janë mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë por Shoqëria i ka ndërtuar për të përmirësuar shërbimin, do të jenë në pronësi të Shoqërisë.

## **1. HYRJE (VAZHDIM)**

### *Marrëveshja e koncesionit (vazhdim)*

#### *Mekanizmi i pagesës*

Çmimi pa TVSH do të jetë 1,537 Lek për person dhe vlera minimale vjetore e pagueshme nga Ministria e Shëndetësisë për Shoqërinë është 730,075,000 Lek pa TVSH për çdo vit.

Nëse numri i personave tejkalon 475,000, Ministria e Shëndetësisë duhet t'i paguajë Shoqërisë diferencën prej 1,537 Lek për cdo kontroll mjekësor të bërë më shumë.

#### *Riinvestimet e Shoqërisë*

Shoqëria ka detyrim të mirëmbajë pronën sipas kontratës së Koncesionit. Shoqëria do të investojë në 4 vitet e fundit të termave të kontratës një shumë prej 129,999,890 Lek.

## **2. BAZA E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazën e përlllogaritjes të specifikuar nga SNRF për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në monedhën Shqiptare Lek.

### **2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara.

Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti Menaxhimi pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e Riinvestimit si aktiv dhe detyrim të ndikohen. Në këtë fazë Menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po shpalosen dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ndikojë gjithashtu në të ardhura, flukset e parave dhe përfitueshmëria. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, 3P Life Logistic shpk vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë bazën e përgatitjes së vazhdimësisë.

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**

#### **3.1 Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën raportuese aktuale.**

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **SNRF 15 "Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **IFRIC 22 "Transaksionet në valutë dhe Konsiderata për Avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **3.2 Standardet e reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në publikim që nuk janë adoptuar ende.**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë"** - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **KIFRN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi.

### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetare që maten në bazë të koston historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Lek / USD	107.82	111.10
Lek / EUR	123.42	132.95

#### 3.4 Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale mbahen me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundshme që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim/humbje në momentin që ato ndodhin.

Amortizimi llogaritet në mënyrë lineare për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të zbatuara janë si në vijim:

Përshkrimi i kategorisë	Përqindje / vit
Ndërtesa	0%
Pajisje zyre	20%
Automjete	20%
Pajisje IT	25%

#### 3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Shoqëria njihet aktiv jomaterial afatgjatë nga një marrëveshje shërbimi konçensionare në momentin kur i lind e drejta për përdorimin e infrastrukturës së konçensionit. Aktivet jomateriale afatgjata janë matur fillimisht me kosto e cila është vlera e drejtë e paguar për të marrë shërbimet konçensionare të marrëveshjes konçensionare. Pas njohjes fillestare aktivet jomateriale afatgjata maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga dëmtimet.

Shoqëria ka aplikuar KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçensionare* të efektshme për periudhën vjetore më apo pas dates 1 janar 2008. Interpretimi është aplikuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me IAS 8 Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet dhe gabimet kontabël të përshkruara në shënimin 22 të pasqyrave financiare. Sipas KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçensionare* aktivet afatgjata jomateriale përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbime konçensionare në këmbim të shpërblimeve jo monetare të kaluara dhënësit të grantit.

*Analiza e ndryshimisë ndaj ndryshimit të normës së interesit të bonove të thesarit*

Periudha	Vlera e riinvestimit	+10%	-10%
Më 31 dhjetor 2018	45,006,880	4,500,688	(4,500,688)
Më 31 dhjetor 2017	52,207,980	5,220,798	(5,220,798)

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.5 Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë përfshin një ndryshim prej 10% të normës së interesit të bonove të thesarit. Rritja / ulja e normës së interesit të bonove të thesarit me 10% ul / rrit vlerën e riinvestimit.

Sipas marrëveshjes ndërmjet Shoqërisë dhe dhënësit të grantit aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë elementët që përfshijnë shpërblime jomonetare në këmbim të shërbimeve konçesionare të marra:

##### *- Shpenzimet vijuese*

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përkasin. Shpenzimi tjetër është i njohur në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje) kur ka ndodhur.

##### *- Amortizimi*

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivit afatgjatë jomaterial që i përket marrëveshjes së shërbimit konçesionar është periudha që kur vendoset në dispozicion deri në fund të periudhës së konçesionit, 10 vjet.

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivit afatgjatë jomaterial që nuk i përket marrëveshjes së shërbimit konçesionar është si më poshtë :

#### **Përshkrimi i kategorisë**

Programe informatike

#### **Përqindje / vit**

25%

#### **3.6 Inventarët**

Inventarët maten me shumën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes.

Kur inventarët konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim në periudhën në të cilën e ardhura përkatëse njihet. Shuma e rënies në vlerë të inventarëve deri në vlerën e realizueshme neto si dhe të gjitha humbjet nga inventarët njihen si shpenzime në periudhën në të cilën rënia në vlerë apo humbja ndodh.

#### **3.7 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë së tij, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes.

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.7 Instrumentat Financiare**

SNRF 9 "Instrumentat financiarë", publikuar më 24 korrik 2014 është zëvendësimi nga BSNK i SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin kërkesat për njohjen dhe matjen, zhvlerësimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e përgjithshëm.

**Klasifikimi dhe matja** - SNRF 9 paraqet një qasje të re për klasifikimin e aktiveve financiarë, e cila është drejtuar nga karakteristikat pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv. Kjo qasje e bazuar në parime, zëvendëson kërkesat ekzistuese të bazuara në rregullat sipas SNK 39. Modeli i ri rezulton gjithashtu në një model të vetëm zhvlerësimi që aplikohet në të gjitha instrumentet financiare.

**Zhvlerësimi** - SNRF 9 ka prezantuar një model të ri për humbjet e pritshme nga zhvlerësimi që do të kërkojë njohjen më në kohë të humbjeve të pritshme të kredisë (humbjet nga kredia). Në mënyrë të veçantë, standardi i ri kërkon që njësitë ekonomike të japin llogari për humbjet e pritshme të kredisë që nga momenti kur instrumentet financiare njihen për herë të parë dhe të njihen humbjet e pritshme të jetës së aktivitetit një një bayë më të duhur.

**Kontabiliteti i mbrojtjes** - SNRF 9 paraqet një model të reformuar në mënyrë të konsiderueshme për kontabilitetin e mbrojtjes, ku është vendosur një rëndësi në aktivitetet e menaxhimit të riskut. Modeli i ri paraqet një rishikim të rëndësishëm të kontabilitetit të mbrojtjes që vendos në një linjë trajtimin kontabël me aktivitetet e menaxhimit të riskut.

**Kreditit i vet** - SNRF 9 heq paqëndrueshmërinë në fitim ose humbje që shkaktohej nga ndryshimet në rrezikun kreditor të detyrimeve të zgjedhura për tu matur me vlerën e drejtë. Ky ndryshim në kontabilitet do të thotë se fitimet e shkaktuara nga përkeqësimi i riskut të kreditit të vet të njësisë ekonomike në detyrime të tilla, nuk njihen me në fitim ose humbje.

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe detyrime tregtare dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative maten si më poshtë.

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.8 Njohja e të ardhurave**

**SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** publikuar nga BSNK më 28 maj 2014 (më 11 shtator 2015 BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të SNRF 15 deri më 1 janar 2018 dhe më 12 prill 2016 BSNK bëri sqarime për këtë standard). SNRF 15 specifikon se si dhe kur një raportues i SNRF-ve do të njohë të ardhurat, si dhe kërkon që subjekte të tilla t'u sigurojnë më tepër informacion përdoruesve të pasqyrave financiare. Standardi zëvendëson SNK 18 "Të Ardhurat", SNK 11 "Kontratat e ndërtimit" si dhe një numër interpretimesh lidhur me të ardhurat. Zbatimi i standardit është i detyrueshëm për të gjithë raportuesit sipas SNRF-ve dhe zbatohet për pothuajse të gjitha kontratat me klientët: përjashtimet kryesore janë qiratë, instrumentet financiare dhe kontratat e sigurimit.

Parimi bazë i standardit të ri është që shoqëritë të njohin të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve të klientët në shuma që reflektojnë shpërblimin (pagesën), për të cilën shoqëria pret të ketë një të drejtë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve. Standardi i ri gjithashtu do të rezultojë në dhënien e shënimeve shpjeguese më të zgjeruara rreth të ardhurave, dhënien e udhëzimeve për transaksionet që nuk janë trajtuar më parë në mënyrë gjithëpërfshirëse (për shembull, të ardhurat nga shërbimet dhe modifikimet e kontratës) dhe përmirësimin e udhëzimeve për marrëveshjet me shumë elementë.

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave të paraqitura si më poshtë për secilën pjesë të identifikueshme të transaksionit të shitjes, në mënyrë që të reflektojë përmbajtjen e transaksionit.

Shpërblimi i marrë nga këto transaksione, është shpërndarë veçmas për secilin komponent duke marrë parasysh vlerën relative të drejtë për secilin komponent.

Këto kritere specifike të njohjes së të ardhurave nga aktiviteti janë bazuar në shërbimin e ofruar konsumatorit dhe kushteve të kontratës. Bazuar në Kontratën e konçesionit midis 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70 vjeç bazuar kushteve të kontratës së konçesionit.

#### **3.9 Përfitimet e detyrueshme të punonjësve**

##### *Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pagave sipas legjislacionit vendor. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.



### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% e të ardhurës së tatueshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Në bazë të pasigurive të lidhura me realizimin e aktivitetit tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e përkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së konçesionit, Shoqëria nuk ka njohur asnjë aktiv tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018.

#### **3.11 Provigjionet**

Provigjionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

Nëse efekti është material, provigjionet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka mundësi për nevojën e një rrjedhë burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjion për humbjet e ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen.

#### **3.12 Angazhime dhe detyrime të ardhshme**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një pasiv të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjion nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim lind në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

**3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**3.13 Riparaqitje e rezultateve financiare për shkak të korigjimit të periudhave paraardhëse**

Gabime kontabël në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen ose zbulimin e elementeve të pasqyrave financiare mund të ndodhin. Sipas SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet", një njësi ekonomike duhet të korigjojë gabimet materiale të periudhës së mëparshme në mënyrë retrospektive në përmbledhjen e parë të pasqyrave financiare të autorizuar për t'u lëshuar pas zbulimit të tyre nga:

(a) riparaqitja e shumave krahasuese për periudhën e mëparshme të paraqitura në të cilat ka ndodhur gabimi; ose

(b) nëse gabimi ka ndodhur para periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, duke ripunuar bilancet fillestare të aktiveve, pasiveve dhe kapitalit për periudhën më të hershme paraardhëse

1. Vlera e riinvestimit është njohur si një pjesë integrale e aktiveve jo-materiale dhe si detyrim. Detyrimi i riinvestimit nuk u njoh në llogarinë e saktë të pozicionit financiar dhe vlera e riinvestimit si detyrim ishte regjistruar në detyrime afatgjata. Si pasojë e një riklasifikimi të tillë, detyrimi i riinvestimit rezultoi me një rritje prej 16,346,823 Lek, duke çuar kështu në uljen e detyrimeve afatgjata të 16,346,823 Lek më 31 Dhjetor 2017. Për sa i përket Shoqërisë ishte një gabim teknik, dhe ai nuk është vërejtur në auditimin e viti të kaluar.
2. Aktive afatgjata jo materiale riklasifikuar në aktive afatgjata materiale, për rrjedhojë, vlera e aktiveve afatgjata materiale rezultoi me një rritje prej 4,409,507 Lek duke sjellë kështu një rënie në aktive afatgjata jo mteriale prej 4,409,507 Lek në datën 31 dhjetor 2017. Për sa i përket Shoqërisë ishte një gabim teknik, dhe ai nuk është vërejtur në auditimin e viti të kaluar.
3. Gjatë auditimit për vitin 2018, u vërejt se disa aktive afatgjata materiale duhej të ishin regjistruar në vitin 2017 në vend të vitit 2018. Si rezultat i këtij rregullimi vlera e aktiveve afatgjata materiale u rrit me 8,351,636 Lek, llogari të pagueshme me 10.543.625 Lek, rritje e shpenzimit të amortizimit prej 2,191,989 Lek, ulja e shpenzimit të tatimit mbi fitimin me 695,778 Lek dhe parapagimet e tatimit mbi fitimin rriten me 271,334 Lek.
4. Gjatë vitit 2018 një gabim në lidhje me njohjen, matjen dhe paraqitjen e pasurisë së rivlerësimit, detyrimit të riinvestimit dhe shpenzimeve financiare. Menaxhmenti i kompanisë korigjoi gabimin sipas kërkesave të SNK 8 "Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet". Të tilla si, Riinvestimi aktiv u ul me 16,346,823 Lek më 31 Dhjetor 2017 (2016: 19,124,955 Lek), Detyrimi i Riinvestimit u ul me 7.673.732 Lek më 31 Dhjetor 2017 (2016: 13,211,534 Lek), dhe shpenzimi financiar u rrit me 2,759,669 Lek për periudhën e përfunduar 31 Dhjetor 2017 (2016: 5,913,421 Lek).

***Pasqyra e pozicionit financiar***

**Më 1 janar 2017**

Aktive afatgjata jomateriale –  
Kontrata e Konçesionit

**Totali i aktiveve**

Vlera e riinvestimit - detyrim

**Totali i detyrimeve**

Fitimi neto

**Kapitali aksionar**

**Ndikimi i korigjimit të gabimeve**

	<b>Raportimi i mëparshëm</b>	<b>Korigjime</b>	<b>Riparaqitje</b>
	78,534,037	(19,124,956)	59,409,081
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>78,534,037</b>	<b>-19,124,956</b>	<b>59,409,081</b>
	85,469,683	8,932,405	94,402,088
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>85,469,683</b>	<b>8,932,405</b>	<b>94,402,088</b>
	72,651,555	(5,913,422)	66,738,133
<b>Kapitali aksionar</b>	<b>72,651,555</b>	<b>(5,913,422)</b>	<b>66,738,133</b>

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

## 3.13 Riparaqitje e rezultateve financiare për shkak të korigjimit të periudhave paraardhëse (vazhdim)

*Pasqyra e fitimit ose humbjes**dhe të ardhurave të tjera**gjithëpërfshirëse*

Për vitin e mbyllur më 1 janar 2017

**Shpenzimet**

Zhvlerësimi dhe amortizimi

Të ardhurat / shpenzimet

financiare, neto

**Fitimi neto i vitit**

## Ndikimi i korigjimit të gabimeve

	Raportimi i mëparshëm	Korigjime	Riparaqitur
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(75,271,465)	2,615,654	(72,655,811)
Të ardhurat / shpenzimet financiare, neto	-	(8,529,077)	(8,529,077)
<b>Fitimi neto i vitit</b>	<b>(75,271,465)</b>	<b>(5,913,422)</b>	<b>(81,184,887)</b>

*Pasqyra e pozicionit financiar*

Më 31 dhjetor 2017

Aktive afatgjata materiale

Aktive afatgjata jomateriale –

Kontrata e Konçesionit

Aktive të tjera

**Totali i aktiveve**

Vlera e riinvestimit

Detyrime të tjera afatgjata

Llogaritë e pagueshme

Detyrime të tjera

**Totali i detyrimeve**

Kapital i nënshkruar por i papaguar

Fitimi neto

**Kapitali aksionar**

## Ndikimi i korigjimit të gabimeve

	Raportimi i mëparshëm	Korigjime	Riparaqitje
Aktive afatgjata materiale	182,660,632	12,761,143	195,421,775
Aktive afatgjata jomateriale – Kontrata e Konçesionit	273,514,333	(20,756,330)	252,758,003
Aktive të tjera	159,115,982	483,759	159,599,741
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>615,290,947</b>	<b>(7,511,428)</b>	<b>607,779,519</b>
Vlera e riinvestimit	85,469,683	8,932,405	94,402,088
Detyrime të tjera afatgjata	274,397,073	(16,606,137)	257,790,936
Llogaritë e pagueshme	77,919,465	10,543,625	88,463,090
Detyrime të tjera	212,222	(212,222)	-
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>437,998,443</b>	<b>2,657,671</b>	<b>440,656,114</b>
Kapital i nënshkruar por i papaguar	-	(5,913,422)	(5,913,422)
Fitimi neto	56,489,703	(4,255,675)	52,234,028
<b>Kapitali aksionar</b>	<b>56,489,703</b>	<b>(10,169,097)</b>	<b>46,320,605</b>

*Pasqyra e fitimit ose humbjes**dhe të ardhurave të tjera**gjithëpërfshirëse*

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

**Shpenzimet**

Zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzime operative dhe të tjera

Të ardhurat / shpenzimet

financiare, neto

Shpenzimet e tatim fitimit

**Fitimi neto i vitit**

## Ndikimi i korigjimit të gabimeve

	Raportimi i mëparshëm	Korigjime	Riparaqitur
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(74,723,736)	4,126,039	(70,597,697)
Shpenzime operative dhe të tjera	(198,274,335)	(226,444)	(198,500,779)
Të ardhurat / shpenzimet financiare, neto	-	(8,851,253)	(8,851,253)
Shpenzimet e tatim fitimit	(13,659,042)	695,983	(12,963,059)
<b>Fitimi neto i vitit</b>	<b>(286,657,113)</b>	<b>(4,255,675)</b>	<b>(290,912,788)</b>

## 4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Pajisje zyre	Pajisje IT	Automjete	Ndërtesa	Pajisje dhe makineri	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>46,844,930</b>	<b>1,926,348</b>	<b>103,992,148</b>	<b>84,677,788</b>	-	<b>237,441,214</b>
Shtesa	9,499,779	6,847,819	-	3,922,508	2,629,962	22,900,068
Pakësime	(986,016)	(310,376)	(1,536,950)	-	-	(2,833,342)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>55,358,693</b>	<b>8,463,791</b>	<b>102,455,198</b>	<b>88,600,296</b>	<b>2,629,962</b>	<b>257,507,940</b>
Shtesa	3,664,848	31,903	-	-	-	3,696,751
Pakësime	(22,867)	(636,358)	-	-	-	(659,225)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>59,000,674</b>	<b>7,859,336</b>	<b>102,455,198</b>	<b>88,600,296</b>	<b>2,629,962</b>	<b>260,545,466</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>(7,453,447)</b>	<b>(721,842)</b>	<b>(20,798,430)</b>	<b>(3,083,901)</b>	-	<b>(32,057,620)</b>
Amortizimi i vitit	(8,790,317)	(1,533,875)	(16,638,744)	(3,974,531)	(131,498)	(31,068,965)
Pakësime	409,252	77,866	553,302	-	-	1,040,420
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>(15,834,512)</b>	<b>(2,177,851)</b>	<b>(36,883,872)</b>	<b>(7,058,432)</b>	<b>(131,498)</b>	<b>(62,086,165)</b>
Amortizimi i vitit	(8,274,370)	(1,573,773)	(13,114,265)	(4,077,093)	(499,693)	(27,539,194)
Pakësime	8,232	268,464	-	-	-	276,696
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(24,100,650)</b>	<b>(3,483,160)</b>	<b>(49,998,137)</b>	<b>(11,135,525)</b>	<b>(631,191)</b>	<b>(89,348,663)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>39,391,483</b>	<b>1,204,506</b>	<b>83,193,718</b>	<b>81,593,887</b>	-	<b>205,383,594</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>39,524,181</b>	<b>6,285,940</b>	<b>65,571,326</b>	<b>81,541,864</b>	<b>2,498,464</b>	<b>195,421,775</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>34,900,024</b>	<b>4,376,176</b>	<b>52,457,061</b>	<b>77,464,771</b>	<b>1,998,771</b>	<b>171,196,803</b>

Asnjë aktiv material afatgjatë nuk është vendosur si kolateral ndaj ndonjë huamarrje në 31 dhjetor 2018 (asnjë: 31 dhjetor 2017).

## 5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE KONTRATA E KONÇESIONIT

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Programe informatike	Software	Riinvestim	Konçesion	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>298,550</b>	-	<b>72,011,007</b>	<b>272,271,406</b>	<b>344,580,963</b>
Shtesa	-	-	-	12,724,923	12,724,923
Pakësime	-	-	-	(2,976,571)	(2,976,571)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>298,550</b>	-	<b>72,011,007</b>	<b>282,019,758</b>	<b>354,329,315</b>
Shtesa	-	431,400	-	3,335,566	3,766,966
Pakësime	-	-	-	(175,512)	(175,512)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>298,550</b>	<b>431,400</b>	<b>72,011,007</b>	<b>285,179,812</b>	<b>357,920,769</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>					
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>(91,669)</b>	-	<b>(12,601,926)</b>	<b>(48,308,566)</b>	<b>(61,002,161)</b>
Amortizimi i vitit	(51,720)	-	(7,201,101)	(33,998,748)	(41,251,569)
Pakësime	-	-	-	682,417	682,417
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>(143,389)</b>	-	<b>(19,803,027)</b>	<b>(81,624,897)</b>	<b>(101,571,313)</b>
Amortizimi i vitit	(38,790)	(80,888)	(7,201,101)	(35,530,579)	(42,851,358)
Pakësime	-	-	-	51,769	51,769
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(182,179)</b>	<b>(80,888)</b>	<b>(27,004,128)</b>	<b>(117,103,707)</b>	<b>(144,370,902)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>					
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>206,881</b>	-	<b>59,409,081</b>	<b>223,962,840</b>	<b>283,578,802</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>155,161</b>	-	<b>52,207,980</b>	<b>200,394,861</b>	<b>252,758,002</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>116,371</b>	<b>350,512</b>	<b>45,006,879</b>	<b>168,076,105</b>	<b>213,549,867</b>

Asnjë aktiv jo-material afatgjatë nuk është vendosur si kolateral ndaj ndonjë huamarrje më 31 dhjetor 2018 (asnjë: 31 dhjetor 2017).

## 6. INVENTARËT

Inventarët më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)
Inventar i imët	13,556,331	26,067,201
Materiale dhe paisje në magazinë	5,321,442	11,433,133
<b>Totali</b>	<b>18,877,773</b>	<b>37,500,334</b>

Inventari i imët përbëhet nga reagentë dhe materiale të tjera mjekësore të nevojshme për të kryer analizat, vlera përfaqëson gjëndje në laboratorë më datë 31 dhjetor 2018. Ndërsa në zërin materiale dhe paisje në magazinë përfshihen objekte, materiale dhe aktive të cilat nevojiten për mirë funksionimin e qendrave shëndetësore si dhe objekte të cilat bëjnë të mundur transportin e analizave nga qendrat shëndetësore në laboratorët përkatës që gjënden në magazinë.

## 7. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2018	Më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)
<b>Llogaritë e arkëtueshme</b>		
Llogaritë e arkëtueshme nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)	146,028,541	146,021,200
Llogaritë e arkëtueshme nga Ministria e Shëndetësisë	173,039	173,000
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,310,488	4,994,995
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>147,512,068</b>	<b>151,189,195</b>
<b>Llogari të tjera të arkëtueshme</b>		
TVSH e arkëtueshme	-	7,926,785
<b>Totali i llogari të tjera të arkëtueshme</b>	<b>-</b>	<b>7,926,785</b>
<b>Totali</b>	<b>147,512,068</b>	<b>159,115,980</b>

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga kontrollet mjekësore të kryera nga Shoqëria që duhet të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor si dhe nga ministria e Shëndetësisë.

## 8. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2018	Më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)
Llogari rrjedhëse në Lek	43,461,509	10,092,252
Llogaritë rrjedhëse në Euro	342,844	76,779
Arka në Lek	-	-
<b>Totali</b>	<b>43,804,353</b>	<b>10,169,031</b>

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në Euro dhe Lek tek banka Intesa SanPaolo dhe Raiffeisen

## 9. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 dhjetor 2018 kapitali aksionar i Shoqërisë është 146,875,553 Lek (më 31 dhjetor 2017: 146,875,553). Aksionet janë të zotëruara tërësisht nga Marketing & Distribution sh.p.k. dhe Trimed sh.p.k. Më 31 dhjetor 2018 nuk ka patur rritje të kapitalit.

## 10. VLERA E RIINVESTIMIT

Detyrimi aktual për të riinvestuar investimin total prej 129,999,890 Lek në 4 vitet e fundit, bazuar në marrëveshjen e konçesionit, është njohur si një detyrim afatgjatë duke qenë se daljet e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të shlyejnë detyrimin në tre vitet e fundit të marrëveshjes. Shoqëria ka vlerësuar vlerën aktuale të detyrimit për shumën e riinvestimit 104,169,108 Lek më 31 dhjetor 2018 (më 31 dhjetor 2017: 94,402,088 Lek).

## 11. DETYRIME TË TJERA AFATGJATA

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)
Detyrime ndaj Marketing&Distribution	140,966,947	240,503,997
Detyrime ndaj Interlogistic	4,941,464	17,286,939
<b>Totali</b>	<b>145,908,411</b>	<b>257,790,936</b>

## 12. LLOGARITË E PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2018	Më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	61,315,115	12,170,327
Të pagueshme ndaj kompanive	22,180,024	71,767,569
Të pagueshme ndaj individëve	4,567,788	4,525,194
<b>Totali</b>	<b>88,062,927</b>	<b>88,463,090</b>

Të pagueshmet tregtare ndaj palëve të lidhura përbëhen nga vlera prej 2,659,784 Lek, që përfaqëson furnizime me materiale mjekësore nga Trimed sh.p.k. dhe 58,655,321.95 Lek nga Marketing&Distribution që përfaqëson shërbime të ndryshme bazuar mbi kontrata.

Të pagueshmet ndaj kompanive, përfaqësojnë investimin për ngritjen e laboratorëve për llogari të Shoqërisë nga Interlogistic sh.p.k bazuar në kontratë midis dy palëve, dhe pjesa tjetër ka të bëjë me shërbimet për mirëmbajtje dhe funksionimin e koncesionit.

Nga ana tjetër, të pagueshmet ndaj individëve lidhen me shërbime nga specialistë të kryera në fillim të biznesit në mënyrë që të krijojnë procesin e biznesit dhe kontrollet e brendshme në laboratorë.

## 13. GRANT APARATURA ABBOT

Grant aparatura abbot më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si vijon:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)
APARATURA ABBOT	-	9,587,803
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>9,587,803</b>

Ne 2015, Shoqëria ka nënshkruar kontratë me palë të tretë për dhurimin e aparaturave ABBOT të laboratorit dhe programit informatik për përdorimin e këtyre aparaturave të nevojshme për të kryer analizat e check-up. Pakësimi në vlerë ka të bëjë me vlerën e amortizimit të pajisjeve për vitin 2017, për rrjedhojë më 31 dhjetor 2018 ky grant është amortizuar plotësisht.

## 14. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)
Pagat e punonjësve	5,055,508	5,105,379
Parapagimet	1,998,184	585,716
Të pagueshme të tjera	580,298	4,571,706
Tvsh e pagueshme	5,679,135	-
<b>Totali</b>	<b>13,313,125</b>	<b>10,262,801</b>



## 15. TË ARDHURA

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Të ardhurat nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	730,075,000	730,773,785
<b>Totali</b>	<b>730,075,000</b>	<b>730,773,785</b>

Të ardhurat përfshijnë vetëm cmimin e kontrolleve mjekësore të kryera nga Shoqëria dhe të paguara nga Garantori.

## 16. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	204,832	1,098,662
Të ardhura të tjera	1,314,812	234,165
Të ardhura Granti- aparatúra abbott	9,587,703	17,632,155
<b>Totali</b>	<b>11,107,347</b>	<b>18,964,982</b>

## 17. SHPENZIME PËR KONTRATËN E KONÇESIONIT

Shpenzimet për kontratën e konçesionit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Shpenzime sipas kontratës me M&D	(196,641,240)	(157,527,236)
Shpenzimet e reagentëve	(145,688,411)	(113,045,769)
<b>Totali</b>	<b>(342,329,651)</b>	<b>(270,573,005)</b>

Shpenzimet e reagentëve përfaqësojnë shpenzimet e bëra për të blerë reagentë për të kryer kontrollet e check-up. Këto janë shpenzimet e bëra me qëllim të kryerjes së shërbimeve sipas marrëveshjes së konçesionit. Shpenzimet sipas kontratës i referohen shërbimeve që M&D kryen në bazë të marrëveshjes dypalëshe, me qëllim ruajtjen dhe mbarëvajtjen e sistemit informatik dhe paisjeve informatike në Qendra shëndetësore, Ambulanca lëvizëse dhe Laboratorë; shërbime logjistike që lidhen me magazinimin dhe lëvizjen e materialeve për kryerjen e analizave, përdorim të sistemeve dhe programeve të domosdoshëm për krijimin dhe ruajtjen e të dhënave të kontrolleve check-up të realizuara.

## 18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Pagat bruto	(104,770,045)	(119,052,921)
Sigurimet shoqërore	(15,810,358)	(16,966,025)
<b>Totali</b>	<b>(120,580,403)</b>	<b>(136,018,946)</b>

## 19. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Shpenzime administrative	(56,589,650)	(52,050,610)
Shpenzime karburanti	(22,475,916)	(22,259,488)
Shpenzime laborator	(19,543,002)	(45,746,896)
Shpenzime qeraje	(7,968,660)	(9,213,120)
Shpenzime mirëmbajtjeje	(7,766,353)	(10,247,430)
Shpenzime disinfektimi dhe heqje të mbetjeve	(6,334,200)	(3,999,348)
Shpenzime transporti dhe dieta	(3,915,010)	(5,633,117)
Shpenzime provigjioni	(3,846,037)	-
Shpenzime të tjera	(2,773,652)	(4,106,240)
Shpenzime ligjore	(1,388,645)	(1,530,548)
Shpenzime operacionale	(203,360)	(260,952)
Komisione bankare	(42,685)	(50,155)
Shpenzime marketing dhe promovimi	(10,542)	(43,402,875)
<b>Totali</b>	<b>(132,857,713)</b>	<b>(198,274,335)</b>

## 20. TË ARDHURA / (SHPENZIME) FINANCIARE

Të ardhurat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, detajohen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>
Të ardhura / (shpenzime) financiare, neto	(9,767,020)	(8,851,253)
Të ardhura nga kursi i këmbimit	45,730	-
<b>Totali</b>	<b>(9,721,290)</b>	<b>(8,851,253)</b>

## 21. TATIMI MBI FITIMIN

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 (riparaqitur)
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>65,631,204</b>	<b>65,197,087</b>
Shpenzimet e pazbritshme	25,652,691	21,223,308
Fitimi tatueshëm	<b>91,283,895</b>	<b>86,420,395</b>
<b>Shpenzim tatim fitimi (15%)</b>	<b>(13,692,584)</b>	<b>(12,963,059)</b>

Shoqëria është subjekt i taksës mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit është 15% për 2018. Formularët e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Ligjet shqiptare dhe rregullat e taksimit janë subjekt i interpretimit nga autoritetet e taksave.

## 22. ANGAZHIME DHE PASIGURI

### *Kërkesa ligjore*

Gjatë aktivitetit normal të saj, Shoqëria mund të jetë subjekt i kërkesave të ndryshme ligjore. Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka patur pretendime ligjore, të cilat konsiderohen normale gjatë rrjedhës së aktivitetit të saj.

### *Angazhimet*

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

## 23. TRANKSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

	Llogari të arkëtueshme	Llogari të pagueshme	Të ardhura	Kostot
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>				
Marketing & Distribution Sh.p.k	-	(159,657,771)	35,220,849	(246,394,583)
Trimed Sh.p.k	-	(2,659,784)	-	(53,056,867)
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>(162,317,555)</b>	<b>35,220,849</b>	<b>(299,451,450)</b>
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>				
Marketing & Distribution Sh.p.k	-	(297,671,986)	2,678,243	(220,446,558)
Trimed Sh.p.k	-	(1,626,702)	17,088	(61,030,665)
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>(299,298,688)</b>	<b>2,695,331</b>	<b>(281,477,223)</b>

## 24. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### 24.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Administrimi i rrezikut bëhet nga drejtimi duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara, të cilat mbulojnë të gjithë administrimin e rrezikut dhe pjesë specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesi, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit.

### 24.2 Rreziku i tregut

#### *Rreziku nga kurset e këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitorojë operacionet me bazë ditore.

Vlera e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë në monedhë të huaj është si më poshtë:

<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>EUR</b>	<b>LEK</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	43,804,353	342,845	43,461,509
Llogari të pagueshme e të tjera	(88,062,927)	(753,232)	(87,309,695)
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(44,258,573)</b>	<b>(410,387)</b>	<b>(43,848,186)</b>

<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>EUR</b>	<b>LEK</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	10,169,031	76,779	10,092,252
Llogari të pagueshme e të tjera	(88,463,090)	(763,177)	(87,699,913)
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(78,294,059)</b>	<b>(686,398)</b>	<b>(77,607,661)</b>

#### *Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>Vlera e ekspozimit, neto</b>	<b>Fitim ose humbje</b>	
		<b>+10%</b>	<b>-10%</b>
EURO	(410,387)	41,039	(41,039)
<b>31 dhjetor 2017</b>		<b>Fitim ose humbje</b>	
		<b>+10%</b>	<b>+10%</b>
EURO	(686,397)	68,640	(68,640)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm mjetet monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerave të tyre është bërë për shkak të një ndryshimi me 10% të kurseve të këmbimit. Vlera pozitive/negative tregon rritje/ulje në fitim ose elemente të tjerë të kapitalit, gjë që ndodh kur monedha Lek dobësohet/forcohet në krahasim me monedhat e tjera të huaja me +/- 10%.

## 24. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### 24.3 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e huave të skeduluara dhe duke parashikuar hyrjet dhe daljet e parave bazuar në rrjedhën e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet monitorohen në grupime të ndryshme kohore. Nevojat neto për mjete monetare në arkë krahasohen me mjetet e disponueshme të huamarrjes në mënyrë që të përcaktohet çdo humbje. Kjo analizë tregon nëse mjetet e disponueshme të huamarrjes janë të mjaftueshme për periudhën në shqyrtim. Shoqëria mban para në arkë dhe bankë për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, detyrimet financiare të Shoqërisë kanë maturime kontraktuale si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2018	Afatshkurtra	Afatgjata	
	1 – 12 muaj	1- 5 vjet	> 5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	43,804,353	-	-
Llogaritë e arketueshme dhe të tjera	146,028,541	1,483,527	-
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	(88,062,927)	(145,908,411)	-
Detyrime të tjera	(13,313,125)	-	-
<b>Totali</b>	<b>88,456,842</b>	<b>(144,424,884)</b>	<b>-</b>

  

Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	Afatshkurtra	Afatgjata	
	1 – 12 muaj	1- 5 vjet	> 5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	10,169,031	-	-
Llogaritë e arketueshme dhe të tjera	146,021,200	13,094,780	-
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	(88,463,089)	(257,790,937)	-
Detyrime të tjera	(10,262,801)	-	-
<b>Totali</b>	<b>57,464,341</b>	<b>(244,696,157)</b>	<b>-</b>

Shumat e mësipërme reflektojnë rrjedhjet kontraktuale të mjeteve monetare, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat kontabël të detyrimeve në datën e raportimit.

### 24.4 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të merret për të shitur një aktiv ose çmimin që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

## 25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Në Dhjetor 2019, një shpërthim i një lloji të ri të koronavirusit, COVID-19, u shfaq në Wuhan, Kinë. Brenda disa javësh, përkundër përpjekjeve për të përmirësuar virusin në Kinë që përfshinte mbyllje të gjerë të qyteteve dhe bizneseve, numri i të infektuarve u rrit ndjeshëm, dhe përtej kufijve të Kinës, përfshirë Shqipërinë. Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit njoftoi një situatë pandemike për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID 19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten të panjohura. Për detaje të mëtejshme, referojuni Shënimit 2.3 "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve".

## **25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Kompania ka nënshkruar një Marrëveshje kredie me Raiffeisen Bank Sh.a. për një linje kredie në vlerën 200,000 Euro. Kjo kontratë ka një kohëzgjatje deri më 15 maj 2020. Linja e kredisë iu lëshua kompanisë për të mbuluar faturat e papaguara, kapitalin punues dhe shpenzimet operationale, të cilat nuk janë përdorur deri në këtë kohë të nënshkrimit të këtij dokumenti. Asnjë hipotekë apo kolateral nuk është siguruar për këtë linjë kredie.

Më 28 Shkurt 2019 Asambleja e Aksionarëve ka vendosur të aprovojë shpërndarjen e fitimeve të mbartura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2016 në shumën totale 45.970,017 Lek dhe 72,651,555 Lek.

Më 8 Mars 2019 Asambleja e Aksionarëve ka vendosur uljen e kapitalit të Kompanisë në vlerën 9,350,044 lek, për pagimin e taksës mbi të ardhurat në lidhje me dividendin e kapitalizuar për t'u shpërndarë aksionarëve.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare përveç atyre përmendur më sipër.